



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
04.04.2023

Me datë 04.04.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Teuta Zaja, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Ermina Gruda, Tereze Brigja, Ardiana Ndreu, Diana Muriqi, Jona Leqeja, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Dhurata Tyli, Age Martini, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Ornela Leka, Erion Metushi, Oltion Luli, Hilmi Lakti, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj, Lulash Nika, Hekuran Gjorretaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Andi Halluni, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Interpelancë me Kryetarin e Bashkisë në lidhje me shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a.*
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin në parim të financimit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikualifikimin e fasadave të disa pallateve në qytetin e Shkodrës"*
3. Pr/Vendim: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak"*
4. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2023"*.
5. Pr/ Vendim: *"Për kalimin e mjetit ambulancë tek njësi vendore e kujdesit shëndetësor Shkodër, për qendrën shëndetësore Dajç"*
6. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Shkodër"*
7. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2024-2026"*
8. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për Bashkinë Shkodër"*

9. Pr/ Vendim: "Për miratim shitesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025"
10. Pr/ Vendim: "Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastra 104, nj.a. Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë "Ëind Stream sh.p.k."
11. Pr/ Vendim: "Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes 0.3201 ha, në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi" ngastra 104, nj.a. Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitet instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Vitalia Albanie".
12. Pr/ Vendim: "Për dhënie në përdorim pa kundërshtpërblim Ministrisë së Mbrojtjes, një sipërfaqe prej 127 m2 në pronësi të Bashkisë Shkodër"
13. Pr/Vendim: "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të tretëve të objektit "Kinema Milenium", ndodhur në zonën kadastrale 8593, pasuria me nr.4/732, 4/731, me adresë Blv Skënderbeu", në pronësi të Bashkisë Shkodër, për një afat 5 vjeçar, me kontratë qiraje nëpërmjet procedurave konkurruese".
14. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari"
15. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyrës së organizimit e funksionimit të tij në Bashkinë Shkodër"
16. Pr/ Vendim: "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër" për vitin 2023"
17. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Saimir Laqja, znj. Mri Marku, z. Pjetër Mhillaj dhe z.Nikolin Gojcaj, banesat e të cilëve u janë dëmtuar nga zjarri"
18. Diskutime jashtë rendit të ditës

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, prandaj mbledhja deklarohet e hapur. Para se të vijohet me votimin e rendit të ditës Znj.Mandija propozon që në mungesë të Kryetarit të Bashkisë të hiqet pika e parë e rendit të ditës, gjithashtu kërkon që të shqyrtohen vetëm pikat 2,3,4,9 dhe 12 të rendit të ditës dhe pjesa tjetër të shtyhet në mbledhjen e radhës. Edhe Z.Halluni mendon se interpelanca me Kryetarin e bashkisë duhet shtyrë dhe ai kërkon gjithashtu të shtojë edhe pikën 17. për shqyrtim pasi mendon se ndihma financiare është e nevojshme t'i akordohet familjeve në fjalë.

Zv/Kryetari Dedaj shpreh dakordësi për pikën 1. Sepse mendon që bie në kundërshtim me nenin 74.pika 1.

Znj.Truma thekson përsëri nevojën e një interpelance me Kryetarin Z.Spahija meqënëse Këshilli bashkiak ka miratuar vendime në lidhje me Ujësjetllës Kanalizime sh.a

Znj.Leqejza po ashtu replikon ,duke u shprehur se meqënëse në buxhetin e Bashkisë Shkodër ka zëra financiar dedikuar kësaj ndërrmarjeje, si rrjedhojë këshillit i lind e drejta kërkesës së llogarisë.

Znj.Brigja kërkon të dijë arsyen e moskalimit në këshill të kërkesës për vendosjen e shtatores së L.Dukagjinit.Për më tepër ajo edhe njëherë thekson faktin e mosprezencës së Kryetarit të bashkisë.

Hidhet në votim rendi i ditës së bashku me propozimet për ndryshim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/Vendimin "*Për miratimin në parim të financimit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikualifikimin e fasadave të disa pallateve në qytetin e Shkodrës*".

Z.Kadija shprehet mbi Pr/Vendimin e propozuar nga Këshilli bashkiak dhe shkurtimisht tregon domosdoshmërinë e ndërhyrjes tek pallatet nq fjalë. Ajo i fton këshilltarët të votojnë miratimin e këtij Pr/Vendimi për të nisur kështu procedurat e ndërhyrjes.

Z.Halluni përgëzon iniciativën dhe vlerëson mbështetjen e FSHZH-së.

Z.Dedaj përgjigjet në lidhje me mosprezencën e kryetarit të bashkisë duke përsëritur faktin e angazhimeve të tij dhe asnjëherë kjo s'duhet marrë si neglizhencë, kurse përsa i përket vendosjes së shtatores së L.Dukagjinit ai shprehet se nismëtarët e kërkesës nuk kanë pranuar kategorikisht të negociojnë për vendin që ato kanë vendosur.Ai mendon se vendimarrje të tilla kërkojnë konsultime dhe prandaj kjo kërkesë nuk është paraqitur në Këshill. Përsa i përket ndërhyrjes në fasadat e sipërpërmendura, Bashkia Shkodër mirëpret cdo investim që i ofrohet qytetit të Shkodrës.

Znj.Kadija shprehet që duke mos dashur të bëhet asnjëherë politikë dhe se në respekt të këshillëtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës Z.Spahija duhet të kishte gjetur kohën për të qënë i pranishëm në mbledhjen e Këshillit.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe thotë që Këshilli bashkiak në bazë të ligjit 139 ka të drejtë të shprehet në lidhje me buxhetin e Bashkisë Shkodër dhe të bëjë tratativa për përfitim fondësh në të mirë të qytetit. Dhe nuk kupton pse vetë Bashkia nuk ka kërkuar mbështetje për investime pra në FSHZH-së.

Z.Sokoli mendon se Bashkia Shkodër ka treguar neglizhencë në lidhje me kërkesën e fondeve,që mund të ishin marrë me kohë.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

2. Vijohet me Pr/ Vendim “Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak”

Fjala për Znj.Murici e cila relaton sipas materialit të përgatitur nga Komisioni i mandateve.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Z.Durim Bullakja bën betimin e tij para Këshillit bashkiak.

3. Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës. Pr/ Vendim “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shkurt 2023”.

Relaton përsëri Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

4. Vijohet me pikën 4 të rendit të ditës. Pr/ Vendim “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2023 dhe programin afatmesëm përfundimtar 2023-2025”

Relaton nga administrata Znj.Shllaku, sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

5. Vijohet edhe me pikën tjetër të rendit të ditës. Pr/ Vendim “Për dhënie në përdorim pa kundërshpërblim Ministrisë së Mbrojtjes, një sipërfaqe prej 127 m2 në pronësi të Bashkisë Shkodër”

Relaton përsëri Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6. Vijohet me rendin e ditës. Pr/ Vendim “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Saimir Laqja, znj. Mri Marku, z. Pjetër Mhillaj dhe z.Nikolin Gojcaj, banesat e të cilëve u janë dëmtuar nga zjarri”

Fjala përsëri për Z.Dedaj i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.Kryetarët e grupeve Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës; Diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj.Brigja merr fjalën përsëri dhe përsërit se nuk gjen arsye të justifikueshme për mosprezenzën e Z.Spahija në mbledhjet e Këshillit.

Znj.Danaj kërkon përsëri të dijë se si do veprohet në lidhje me Kinema "Millenium".

Z.Dedaj përgjigjet se një nga pikat që u hoqën nga rendi i ditës ishte edhe Pr/vendimi për kinema "Millenium". Ai thotë se ato kanë sjellë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në Këshill dhe vazhdojnë të mbasin të hapur për cdo mendim.

Përsëri Znj.Danaj shprehet se komisioni ka vendosur që Kinema "Millenium" të mbetet dhe të administrohet si aset i Bashkisë Shkodër dhe jo të jepet me qira.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

Kryetarja e Këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmblodhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 04.04.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 5 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

KRYETARE

Brisela KADIJA

